



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2026

Shtojca 12

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data.02.07.2026

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BAMI HOLDING” SHPK me numër NIPTI J94416206R,
Adresa: Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Rruga Kamas.

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-73342-12-24-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Mamurras”.

Fondi limit: 59,108,822 (pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë / 3 muaj.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 29.12.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Nr.85,
datë 31.12.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK me numër NIPTI L78006801F & “VARAKU E” SHPK, me numër NIPTI J61902509S.
Vlera e ofertuar: 38,890,688.83 (tridhjetë e tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK me numër NIPTI M56827701I & “BIBA-X” SHPK, me numër NIPTI K32618815N.

Vlera e ofertuar: 39,795,559.20 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë njëzet) lekë **pa TVSH.**

3. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“Caushi M” SHPK** me numër NIPTI **L88419801O & “K.M.K” SHPK**, me numër NIPTI **L78223801E.**

Vlera e ofertuar: 40,435,890 (dyzet milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë **pa TVSH.**

4. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“NDREGJONI” SHPK** me numër NIPTI **K31329048I & “RAFIN COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **L52125110A.**

Vlera e ofertuar: 43,443,807 (dyzet e tre milion e katërqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e shtatë) lekë **pa TVSH.**

5. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“ERGI” SHPK**, me numër NIPTI **K02727229P & “BE - IS SH.P.K” SHPK** me numër NIPTI **K71412003A.**

Vlera e ofertuar: 43,995,580 (dyzet e tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë **pa TVSH.**

6. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“B93 II” SHPK** me numër NIPTI **L52209050O & “MAKARESH” SHPK**, me numër NIPTI **K24725213C.**

Vlera e ofertuar: 44,619,594 (dyzet e katër milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë **pa TVSH.**

7. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“INA” SHPK** me numër NIPTI **J61814009W & “EUROBETON” SHPK**, me numër NIPTI **K23116602P.**

Vlera e ofertuar: 45,413,657 (dyzet e pesë milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë **pa TVSH.**

8. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK** me numër NIPTI **K82230002K & “STERKAJ” SHPK**, me numër NIPTI **J68310708M.**

Vlera e ofertuar: 46,719,843.5 (dyzet e gjashtë milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e tre pikë pesë) lekë **pa TVSH.**

9. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“LIQENI VII” SHPK**, me numër NIPTI **K01730502W & “SARDO” SHPK**, me numër NIPTI **K13120402W.**

Vlera e ofertuar: 47,129,042 (dyzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e nëntë mijë e dyzet e dy) lekë **pa TVSH.**

10. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“2 N” SHPK**, me numër NIPTI **L31615017L & “BONUS Sh.p.k” SHPK**, me numër NIPTI **K72412009E.**

Vlera e ofertuar: 47,762,683 (dyzet e shtatë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë **pa TVSH.**

11. Operatori ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me numër NIPTI **J94416206R.**

Vlera e ofertuar: 50,235,940.20 (pesëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet pikë njëzet) lekë **pa TVSH.**

12. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “PE - VLA - KU” SHPK, me numër NIPTI K61716013M & “CARA” SHPK, me numër NIPTI K07729920F.
Vlera e ofertuar: 51,853,220 (pesëdhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet) lekë pa TVSH.
13. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “XHAŠT SHPK” SHPK, me numër NIPTI K12512837I & “MELA.” SHPK, me numër NIPTI K62320011G.
Vlera e ofertuar: 53,423,197.80 (pesëdhjetë e tre milion e katërqind e njëzet e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK me numër NIPTI L78006801F & “VARAKU E” SHPK, me numër NIPTI J61902509S.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. OE skualifikohet për ofertë anomalisht të ulët për sa më poshtë:

KVO pasi verifikoi dokumentacionin në SPE, konstatoi se oferta të vlefshme të cilat plotësojnë kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga AK në DST janë 5 oferta, konkretisht si vijon:

Operatori ekonomik

Oferta e operatorit ekonomik pa TVSH

- | | |
|--|---------------|
| 1. BOE “L.T.E CONSTRUCTION” SHPK & “VARAKU E” SHPK | 38,890,688.83 |
| 2. BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK & “STERKAJ” SHPK | 46,719,843.5 |
| 3. OE “BAMI HOLDING” SHPK | 50,235,940.20 |
| 4. BOE “PE - VLA - KU” SHPK & “CARA” SHPK | 51,853,220 |
| 5. BOE “XHAŠT SHPK” SHPK & “MELA.” SHPK | 53,423,197.80 |

Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Sipas DST, Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

$MO = 38,890,688.83 + 46,719,843.5 + 50,235,940.20 + 51,853,220 + 53,423,197.80 =$
241,122,890.33 / 5 = 48,224,578.06

PR = 48,224,578.06 x 85% = 40,990,891.35

Sipas formulës cdo ofertë e cila është më e ulët se **40,990,891.35** është ofertë me çmim anomalisht të ulët.

Duke qënë se oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë **“L.T.E CONSTRUCTION” SHPK & “VARAKU E” SHPK** është më vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, **kjo ofertë është me çmim anomalisht të ulët.**

Në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se:
.....Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve

Gjithashtu edhe në DST, tek Seksioni I, germa f, pika 22, parashikohet ndër të tjera se:....*Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve*

Sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë **“L.T.E CONSTRUCTION” SHPK & “VARAKU E” SHPK me vlerë: 38,890,688.83**, s’kualifikohet si rezultat i ofertës anomalisht të ulët, bazuar në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK me numër NIPTI M56827701I & “BIBA-X” SHPK, me numër NIPTI K32618815N.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. BOE nuk plotëson pikën 2.2.1 të DST (për xhiron...vitet financiare 2023, 2024):

KVO konstatoi se: BOE “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK & “BIBA-X” SHPK nuk plotëson pikën 2.2.1 të DST, konkretisht pikën 2.2.1 nuk e plotëson lideri i BOE, operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK.

Sqarojmë se AK në DST, tek pika 2.2.1 ndër të tjera ka kërkuar se: *...operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2023, 2024.....Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit....etj.* Por KVO pasi verifikoi dokumentacionin konstatoi se, operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK, nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 dhe 2024, kriter ky i kërkuar nga AK në DST.

2. BOE nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST (për bilancet...vitet financiare 2023, 2024):

KVO konstatoi se: BOE “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK & “BIBA-X” SHPK nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST, konkretisht pikën 2.2.2 nuk e plotëson lideri i BOE, operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK.

Sqarojmë se AK në DST, tek pika 2.2.2 ndër të tjera ka kërkuar se: *...operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024),.....Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit....etj.* Por KVO pasi verifikoi dokumentacionin konstatoi se, operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” SHPK, nuk ka paraqitur bilancet vjetore për vitet financiare 2023 dhe 2024, kriter ky i kërkuar nga AK në DST.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “Caushi M” SHPK me numër NIPTI L88419801O & “K.M.K” SHPK, me numër NIPTI L78223801E.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku

parashikohet se:, **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. BOE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme):

KVO konstatoi se: BOE “Caushi M” SHPK & “K.M.K” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme), konkretisht pikën 2.3.1 nuk e plotëson lideri i BOE, operatori ekonomik “Caushi M” SHPK.

Pasi verifikuam dokumentacionin që BOE ka ngarkuar në SPE, rezulton se sipas Akt-Marrëveshjes (për BOE), datë 22.01.2026, Shoqëria “Caushi M” SHPK (përfaqësuesi i BOE), ka marrë përsipër 39.81% të punimeve. Gjithashtu tek ndarja e punimeve, tek objekti 1. Rruga Katun i ri Zheje dhe objekti 5. Rruga Tugve Gjorem (“Caushi M” SHPK ka marrë përsipër realizimin e zërit të punimeve të preventivit me **“Nr. 17. Shtresë binder perzier me asfalto beton 50% me 50% trashesia 6cm me granil me gur kave me makineri përhapur e ngjeshur me mak”**).

Ndërsa për kontratë të ngjashme OE “Caushi M” SHPK, ka ngarkuar në SPE, 2 (dy) kontrata si më poshtë:

1. Kontratën Nr.10993 Prot, datë 24.11.2022, me objekt: “Ndertim rruget blloku Babrru, Shpat 2 Komplet”, të lidhur me Bashkinë Kamëz. Ku nga verifikimi i kësaj kontrate (referuar Akt Marrëveshjes datë 13.10.2022), rezulton se OE “Caushi M” SHPK, ka realizuar 35.19% të punimeve, ku nga punimet që ka realizuar konstatohet se, ky OE nuk ka kryer punë të ngjashme që korespondojnë me zërat e preventivit që AK ka prokuruar (**Shtresë binder perzier me asfalto beton**).
2. Kontratën Nr.15117/8 Prot, datë 02.08.2023, me objekt: “Ndertim i rrugëve “Bedri Karapici”, “Hamdi Pepa” dhe “Bernardin Palja”, të lidhur me Bashkinë Tiranë. Ku nga verifikimi i kësaj kontrate (referuar Akt Marrëveshjes datë 22.06.2023), rezulton se OE “Caushi M” SHPK, ka realizuar 20.83% të punimeve, ku nga punimet që ka realizuar konstatohet se, ky OE nuk ka kryer punë të ngjashme që korespondojnë me zërat e preventivit që AK ka prokuruar (**Shtresë binder perzier me asfalto beton**).

Sqarojmë se punimet kryesore në këtë procedure janë (punime shtresë binder perzier me asfalto beton) pasi kemi të bëjmë me shtrim rrugësh me asfalt.

Del qartë se kontratat e ngjashme që ka paraqitur “Caushi M” SHPK (lideri i BOE), nuk janë bindëse si dhe nuk garanton AK për realizimin e kontratës me sukses, pasi ky OE nuk ka provuar se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit (konkretisht për zërat e preventivit: **Shtresë binder perzier me asfalto beton**).

4. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “NDREGJONI” SHPK me numër NIPTI K31329048I & “RAFIN COMPANY” SHPK, me numër NIPTI L52125110A.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

KVO pasi shqyrtoi/rivlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDREGJONI” SHPK & “RAFIN COMPANY” SHPK, dokumentacion i cili është protokolluar në Bashkinë Kurbin me Nr.6164/15 Prot, datë 20.04.2026, konstatoi se BOE **nuk plotëson pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8 dhe 2.3.9 të DST**, pasi rezultoi se: **I gjithë Stafi (punonjësit), të gjitha mjetet dhe paisjet** që BOE ka deklaruar në këtë procedurë prokurimi, i ka deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt: *“Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Laç”* për të cilën është lidhur Kontrata e Sipërmarrjes Nr.6156/21 Prot, datë 17.04.2026 me Bashkinë Kurbin (informacion i cili na u vu në dispozicion nga njësia e Prokurimit).

Ndodhur para këtij fakti që BOE aktualisht ka një kontratë të lidhur me Autoritetin tonë Bashkinë Kurbin, si dhe duke qenë se **i gjithë Stafi (punonjësit), të gjitha mjetet dhe paisjet**, rezultojnë të angazhuara në objektin: *“Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Laç”*, KVO, vendos të s’kualifikojë BOE NDREGJONI” SHPK & “RAFIN COMPANY” SHPK, për këtë procedure.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë NDREGJONI” SHPK & “RAFIN COMPANY” SHPK, **S’Kualifikohet**.

5. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “ERGI” SHPK, me numër NIPTI K02727229P & “BE - IS SH.P.K” SHPK me numër NIPTI K71412003A.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e**

dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme..... oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “BE - IS SH.P.K” SHPK, dokumentacion i cili u protokollua në Bashkinë Kurbin me Nr.6164/20 Prot, datë 13.05.2026, konstatoi se ky bashkim operatorësh ekonomikë **nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST**, si më poshtë:

Së pari: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “BE - IS SH.P.K” SHPK, nuk plotëson pikën 2.2.3 të DST, konkretisht pikën 2.2.3 të DST, nuk e plotëson operatori ekonomik “ERGI” SHPK (Lider me 43% të punimeve), pasi nuk ka paraqitur dokument që vërteton se ka paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2025.

Autoriteti Kontraktor në DST, tek pika 2.2.3 ka kërkuar se: *2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 (referuar QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ” Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

KVO pasi verifikoi dokumentacionin fizik konstatoi se, operatori ekonomik “ERGI” SHPK, nuk ka paraqitur dokument që vërteton se ka paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2025.

Referuar Ekstraktit Historik, rezulton se OE “ERGI” SHPK në Elbasan ka zyrën qendrore, si dhe me datë 03.02.2025 në QKB është shtuar adresa: *Elbasan, Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare Fadil Gurmani, Elbasan.*

Sqarojmë se ky operator ekonomik për plotësimin e pikës 2.2.3, ka sjellë këto dokumenta: *Njoftim detyrimi, Faturë nga Bashkia Elbasan për taksat vendore 2024, dy Mandat Pagese nga BKT (Mandat pagese datë 15.04.2024 & mandat pagese datë 17.04.2024) si dhe Vërtetim nr.1216 Prot, datë 12.06.2024 leshuar nga Bashkia Elbasan.*

Pra del qartë se operatori ekonomik ka paguar taksat vendore për Bashkinë Elbasan në vitin 2024, por nuk ka paraqit asnjë dokumentacion se ka paguar taksat vendore për vitin 2025 në Bashkinë Elbasan, kriter ky i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Së dyti: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “BE - IS SH.P.K” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, pasi nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor për mjetet si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “ERGI” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për 2 mjete Kamion me vinç sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik, konstatohet se për mjetin Kamion me vinç me targë AA557NB **munjon certifikata e transportin**, nuk është paraqitur fare, ndërsa për mjetin Kamion me vinç me targë AB226CS **Taksat Vjetore** kanë vlefshmëri deri me datë 05.07.2025.

2. Operatori ekonomik “ERGI” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Autobot Uji me targë EL1401C sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik, konstatohet se për këtë mjet **Taksat Vjetore** kanë vlefshmëri deri me datë 31.07.2025.
3. Operatori ekonomik “ERGI” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Fadromë me goma me targë AA946IV sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik, konstatohet se për këtë mjet **Polica/Siguracioni** ka vlefshmëri deri me datë 22.07.2025.
4. Operatori ekonomik “BE - IS SH.P.K” SHPK, nuk ka paraqitur fare dokumentacion për mjetet Kamion me vinç me targë AB764PV si dhe Autobot Uji me targë AB731JV. Sqarojmë se operatori ekonomik “BE - IS SH.P.K” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 8, ka deklaruar Kamion me vinç me targë AB764PV si dhe Autobot Uji me targë AB731JV, ku nga verifikimi i dokumentacionit fizik rezulton se nuk ka paraqitur fare asnjë dokumentacion për këto dy mjete.
5. Operatori ekonomik “BE - IS SH.P.K” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Fadromë me goma me targë AFMT52 sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik, konstatohet se për këtë mjet **Taksat Vjetore** kanë vlefshmëri deri me datë 26.10.2025.
6. Gjithashtu operatori ekonomik “ERGI” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin Rimorkiator me targë ACR179 sipas kërkesave të përcaktuara në DST nga Autoriteti Kontraktor. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik, konstatohet se për këtë mjet Çertifikata e Kontrollit Teknik, Polica dhe Taksat Vjetore kanë vlefshmëri deri 2025 si dhe nuk ka paraqitur fare Çertifikatë Transporti, ndërsa për Autobetoniere me targë AA460TU nuk ka paraqitur Leje qarkullimi / Çertifikatë pronësie.

Për sa më sipër, përderisa BOE nuk vërteton se plotëson dokumentacionin për mjetet në kohën e ofertimit, si dhe nuk plotëson/paraqet dokumentacionin sipas kërkesave që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST, ky BOE s’kualifikohet.

Së treti: Pas verifikimit të dokumentacionit, konstatohet se subjekti mbështetës operatori ekonomik “2 T” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca 8, ka deklaruar Artur Selfo – Administrator dhe Artan Sako Ortak të shoqërisë, ndërsa edhe në QKB këto të dy kanë këto detyra. Por konstatohet se për z.Artur Selfo dhe z. Artan Sako nuk është paraqitur fare Vërtetim për Gjendjen Gjyqësore nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Gjithashtu sqarojmë se operatori ekonomik “ERGI” SHPK, ka paraqitur Vërtetim për Gjendjen Gjyqësore nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zj.Erjona Bajraktari (vërtetim i cili mban datën 29.05.2025), vërtetim për z.Ergi Balla (vërtetim i cili mban datën 03.07.2025) dhe vërtetim për z.Nuri Balla (vërtetim i cili mban datën 25.07.2025), vërtetime të cilat nuk pranohen pasi janë lëshuar rreth gjashtë muaj para ofertimit.

Së katërti: Pas verifikimit të dokumentacionit, konstatohet se BOE, ka paraqitur Formularin e ofertës si dhe Kontratë Furnizimi date 9.06.2022 lidhur me Vellezërit Hysa (për asfaltobeton....etj), ku sqarojm se ky dokumentacion është fotokopje.

Për sa më sipër, KVO nuk mund të kualifikojë një operator ekonomik, i cili nuk plotëson/paraqet dokumentacionin sipas kërkesave që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERGI” SHPK & “BE - IS SH.P.K” SHPK, **S’Kualifikohet.**

6. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “B93 II” SHPK me numër NIPTI L522090500 & “MAKARESH” SHPK, me numër NIPTI K24725213C.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. BOE nuk plotëson pikën 2.3.6.B të DST (për puntorë të thjeshtë 16):

KVO konstatoi se: BOE “B93 II” SHPK & “MAKARESH” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.6.B të DST (për puntorë të thjeshtë 16).

Pasi verifikuam dokumentacionin që BOE ka ngarkuar në SPE, konstatuam se asnjëri nga BOE nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit pikën 2.3.6.B të DST (për puntorë të thjeshtë 16), kriter ky i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

2. BOE nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST (për mjetet):

KVO konstatoi se: BOE “B93 II” SHPK & “MAKARESH” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST (për mjetet), konkretisht për Fadrome me goma 1 dhe për Nyje Asfalti.

Pasi verifikuam dokumentacionin që BOE ka ngarkuar në SPE, konstatuam se asnjëri nga BOE nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Fadromë me goma cope 1, si dhe Nyje Asfalti cope 1, kriter ky i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

7. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “INA” SHPK me numër NIPTI J61814009W & “EUROBETON” SHPK, me numër NIPTI K23116602P.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. BOE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme):

KVO konstatoi se: BOE “INA” SHPK & “EUROBETON” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme), konkretisht pikën 2.3.1 nuk e plotëson lideri i BOE, operatori ekonomik “INA” SHPK.

Pasi verifikuam dokumentacionin që BOE ka ngarkuar në SPE, rezulton se sipas Akt-Marrëveshjes (për BOE), Nr.241 Rep, datë 14.01.2026, Shoqëria “INA” SHPK (përfaqësuesi i BOE), ka marrë përsipër 95% të punimeve (pra pothuajse gjithë kontratën do ta realizojë OE “INA” SHPK).

Për kontratë të ngjashme OE “INA” SHPK, ka ngarkuar në SPE, vetëm 1 (një) kontratë për të cilën ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë Nr.4500507657, me objekt: Punime civile mekanike KRAKOW-BALICE POLAND, të lidhur me Agjencinë e Natos për mbështetjen dhe Prokurimin (më tej e cilësuar NSPA)
2. Çertifikatë Pranimi, datë 04.03.2024
3. Email datë 02.09.2024 dhe datë 04.09.2024.
4. Deklaratë për punën e ngjashme lëshuar nga OE INA.

Ndërsa Autoriteti Kontraktor në DST tek pika 2.3.1, ndër të tjera ka kërkuar: Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- **Situacionin përfundimtar (me zëra punimesh);**
- Aktin e kolaudimit;

KVO pasi verifikoi dokumentacionin që OE “INA” SHPK, ka paraqitur për kontratë të ngjashme, konstatoi se ky OE nuk ka paraqitur **Situacionin përfundimtar (me zëra punimesh)**, gjithashtu nuk ka paraqitur asnjë preventiv që të vërtetojë se cfarë pune ka

realizuar, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër me vërtetë se çfarë zëra punimesh ka realizuar, në mënyrë që komisioni të bindet se kjo kontratë është e ngjashme me objektin e prokurimit që Autoriteti Kontraktor ka prokuruar.

Sqarojmë se tek *Kontrata Nr.4500507657, me objekt: Punime civile mekanike KRAKOW-BALICE POLAND*, që OE ka paraqitur, në faqen 2 të saj, tek TABELA E PËRMBAJTJES shkruhet ndër të tjera shprehimisht se: *Kjo kontratë përbehet nga: Shtojca D: Preventivi i sasive..... Shtojca H: Propozimi/Oferta e Kontraktorit..... të gjitha këto janë pjesë e kontratës.....etj.* Dokumentacion të cilin OE nuk e ka paraqitur në SPE.

Del qartë se kontrata e ngjashme që ka paraqitur OE “INA” SHPK (lideri i BOE), nuk është e plotë, pra nuk është bindëse si dhe nuk garanton AK për realizimin e kontratës me sukses, pasi ky OE nuk ka provuar se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit që Autoriteti Kontraktor ka prokuruar.

8. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK me numër NIPTI K82230002K & “STERKAJ” SHPK, me numër NIPTI J68310708M.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK & “STERKAJ” SHPK, dokumentacion i cili u protokollua në Bashkinë Kurbin me Nr.6164/26 Prot, datë 17.06.2026, konstatoi se BOE **nuk plotëson pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8 dhe 2.3.9 të DST**, pasi rezulton se: **I gjithë Stafi (punonjësit), të gjitha mjetet dhe paisjet** që BOE ka deklaruar në këtë procedurë prokurimi, i ka deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt: *“Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Milot dhe Fushe Kuqe”* për të cilën është lidhur Kontrata e Sipërmarrjes Nr.6163/35 Prot, datë 19.06.2026 me Bashkinë Kurbin.

Ndodhur para këtij fakti që BOE aktualisht ka një kontratë të lidhur me Autoritetin tonë Bashkinë Kurbin, si dhe duke qenë se **i gjithë Stafi (punonjësit), të gjitha mjetet dhe paisjet**, rezultojnë të angazhuara në objektin: *“Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Milot dhe Fushe Kuqe”*, KVO, vendos të s’kualifikojë BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK & “STERKAJ” SHPK, për këtë procedure.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK & “STERKAJ” SHPK, **S’Kualifikohet**.

9. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK, me numër NIPTI K01730502W & “SARDO” SHPK, me numër NIPTI K13120402W.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. BOE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme):

KVO konstatoi se: BOE “LIQENI VII” SHPK & “SARDO” SHPK nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST (për punë të ngjashme).

Pasi verifikuam dokumentacionin që BOE ka ngarkuar në SPE, rezulton se sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit (për BOE), datë 22.01.2026, Shoqëritë kanë ndarë punimet, ku “LIQENI VII” SHPK (përfaqësuesi i BOE), ka marrë përsipër 90% të punimeve dhe “SARDO” SHPK ka marrë përsipër 10% të punimeve. Gjithashtu tek ndarja e punimeve të dy OE (“LIQENI VII” SHPK & “SARDO” SHPK) kanë marrë përsipër realizimin e zërit të punimeve të preventivit me ***“Nr. 17. Shtresë binder perzier me asfalto beton 50% me 50% trashesia 6cm me granil me gur kave me makineri perhapur e ngjeshur me mak”***).

Ndërsa për kontratë të ngjashme OE “LIQENI VII” SHPK, ka ngarkuar në SPE, vetëm një kontratë si më poshtë:

1. Kontratën Nr.11770 Prot, datë 21.12.2021, me objekt: “Ndertim rruga Demokracia Loti III, Bathore”, të lidhur me Bashkinë Kamëz. Ku nga verifikimi i kësaj kontrate (referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit, datë 19.07.2021 dhe Preventivit që kanë ndarë punimet), rezulton se OE “LIQENI VII” SHPK, ka realizuar 39% të punimeve, ku nga punimet që ka realizuar konstatohet se, ky OE nuk ka kryer punë të ngjashme që korespondojnë me zërat e preventivit që AK ka prokuruar (**Shtresë binder perzier me asfalto beton**).

Për kontratë të ngjashme OE “SARDO” SHPK, ka ngarkuar në SPE, vetëm një kontratë si më poshtë:

1. Kontratën Nr.2581/20 Prot, datë 20.09.2022, me objekt: “Mbyllje Kanali të hapur në rrugën Papa Klemendi II (550ML)”, të lidhur me Bashkinë Durrës. Ku nga verifikimi i kësaj kontrate (referuar Situacionit Përfundimtar), rezulton se OE “SARDO” SHPK, nga punimet që ka realizuar konstatohet se, ky OE nuk ka kryer punë të ngjashme që korespondojnë me zërat e preventivit që AK ka prokuruar (**Shtresë binder perzier me asfalto beton**), po ashtu sqarojmë se zërat e punimeve janë *germime, mbushje me cakull, zhavorr, transport etj* që nuk është punë e ngjashme me objektin që AK ka prokuruar.

Sqarojmë se punimet kryesore në këtë procedure janë (punime shtresë binder perzier me asfalto beton) pasi kemi të bëjmë me shtrim rrugësh me asfalt.

Del qartë se kontratat e ngjashme që kanë paraqitur BOE “LIQENI VII” SHPK & “SARDO” SHPK, nuk janë bindëse si dhe nuk garantojnë AK për realizimin e kontratës me sukses, pasi ky BOE nuk ka provuar se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit që Autoriteti Kontraktor ka prokuruar (konkretisht për zërat e preventivit: **Shtresë binder perzier me asfalto beton**).

10. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “2 N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L & “BONUS Sh.p.k” SHPK, me numër NIPTI K72412009E.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. Operatori ekonomik “2 N” SHPK, nuk plotëson pikat 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.8 dhe 2.3.9 të DST për sa më poshtë vijon:

KVO pasi verifikoi dokumentacionin në SPE, konstatoi se: Stafë (punonjësit), mjetet dhe paisjet që operatori ekonomik “2 N” SHPK (lider me 93.89%), ka deklaruar në këtë procedurë prokurimi, i ka deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt: “*Asfaltim rruga Nerlallaj Milot, Bashkia Kurbin*”, procedurë e cila është zhvilluar dhe lidhur kontratë me Bashkinë Kurbin.

Ndodhur para këtij fakti, referuar shkresës Nr.681 Prot, datë 06.02.2026 “*Kërkesë për informacion lidhur me subjektin/operatorin ekonomik “2 N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L*”, KVO i ishte drejtua DPKZHT në Bashkinë Kurbin, duke i kërkuar informacion për kontratën e sipërcituar.

Me shkresën Nr.681/1 Prot, datë 26.02.2026 “Kthim përgjigje”, DPKZHT e Bashkisë Kurbin kishte informuar KVO ndër të tjera se:.....*Subjekti “2 N” shpk me përfaqësues ligjor Z. Ndriçim Stojku i cili ka një kontratë për objektin “Asfaltim rruga Nerlalaj Milot, Bashkia Kurbin”, ka deklaruar fillimin e punimeve me datë 29.12.2025 me anë të shkresës protokolluar datë 29.12.2025 dhe Nr.6201 Prot,. Theksojmë se me datë 05.01.2026 subjekti ka njoftuar zyrtarisht që punimet janë pezulluar dhe nëpërmjet një njoftimi të dytë punimet kanë rifilluar me datë 02.02.2026. Njoftimi mbi përfundimin e punimeve nuk është depozituar pranë Bashkisë Kurbin.....etj.*

Procedura e prokurimit që po rivlerësojmë, me objekt: “Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Mamurras” është publikuar në SPE me datë 29.12.2025 dhe zhvilluar me datë 22.01.2026, kohë në të cilën operatori ekonomik ka pasur dijeni se stafin, mjetet dhe paisjet i ka deklaruar edhe në procedurën me objekt: “Asfaltim rruga Nerlalaj Milot, Bashkia Kurbin”.

Gjithashtu, operatori ekonomik për procedurën me objekt: “Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Mamurras”, ka paraqitur në SPE Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në të cilën shprehet ndër të tjera tek:Pika D. **Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera.....** *Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi.....stafi teknik.....të deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk janë të angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.*

Sa më sipër del qartë se, stafi, mjetet dhe paisjet që OE “2 N” (lider me 93.89%) ka deklaruar në procedurën me objekt: “Asfaltim i rrugëve në Njësinë Administrative Mamurras”, janë deklaruar edhe në procedurën me objekt: “Asfaltim rruga Nerlalaj Milot, Bashkia Kurbin” dhe për këtë arsye, bazuar në nenet 76 pika 3, dhe 92 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë “2 N” SHPK & “BONUS Sh.p.k” SHPK, s’kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me adresë: Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Rruga Kameras, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **50,235,940.20** (pesëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet pikë njëzet) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA